



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

**Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural**  
**Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja**  
**Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development**

**Kabineti i Ministrit / Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister**

**UDHËZIM ADMINISTRATIV (MBPZHR) - NR.17/2024**  
**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E UDHËZIMIT**  
**ADMINISTRATIV (MBPZHR) NR.04/2016 PËR LICENCIMIN E**  
**PRODHUESVE DHE RI PAKETUESVE TË PLEHRAVE**  
**ARTIFICIALE**

<sup>1</sup> Udhëzim Administrativ (MBPZHR) - Nr.17/2024 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) NR. 04/2016 për licencimin e prodhuesve dhe ri paketuesve të plehrave artificiale, i nënshkruar nga Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me datën 09.08.2024.

	REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO MINISTRIA E BUDJESISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, ŠUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT Arkivi Qendror - Centralna Arhiva - Central Archive
Nr./Br./No.	3075
Nr. i fq./Br. Str./No. pg.	3+3+3
Data/Datum/Date:	13.08.2024
PRISHTINË - PRIŠTINA - PRISTINA	

Në mbështetje të nenit 5, nenit 17 paragrafi 17.1 të Ligjit Nr.2003/10 për Plehra Artificiale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.16/01 Shtator 2007), duke marrë parasysh nenin 12 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare, Nr. 07, dt. 01 Mars 2019), në pajtim me nenin 9 paragrafi 2 të Rregullore (QKR) - Nr. 17/2024 e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare 21.06/2024), Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural,

Nxjerrë:

**UDHËZIM ADMINISTRATIV (MBPZHR)-NR.17/2024  
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E UDHËZIMIT ADMINISTRATIV  
(MBPZHR) NR.04/2016 PËR LICENCIMIN E PRODHUESVE DHE RI  
PAKETUESVE TË PLEHRAVE ARTIFICIALE**

**DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1  
Qëllimi**

Ky Udhëzim Administrativ ka për qëllim ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) NR. 04/2016 për licencimin e prodhuesve dhe ri paketuesve të plehrave artificiale, me qëllim të krijimit të bazës ligjore për zbatimin e akteve nënligjore nga Agjencia për Ushqim dhe Veterinari që i përcaktojnë licencimin e prodhuesve dhe ri paketuesve të plehrave artificiale.

**Neni 2**

Në nenin 3 të Udhëzimit Administrativ bazik, fjalia “Departamenti për Politika Bujqësore dhe Tregje” zëvendësohet me fjalinë “Agjencia për Ushqim dhe Veterinari”.

**Neni 3**

1. Neni 7 nën-paragrafi 1.1 i Udhëzimit Administrativ bazik, riformulohet si në vijim:

1.1. Të jetë i regjistruar në ARBK”,

Neni 7 pas nën paragrafit 1.8 të Udhëzimit Administrativ bazik, shtohet një paragraf i ri si në vijim:

2. Në sistemin elektronik krijohet forma e licencës elektronike dhe ka vlerën e njëjtë si certifikata fizike e cila mund të shkarkohet nga personi në çdo kohë përmes këtij sistemi.

**Neni 4**

Neni 9 i Udhëzimit Administrativ bazik, fshihet.

### **Neni 5**

Në nenin 10 të Udhëzimit Administrativ bazik, fjala “Departamenti për Politika Bujqësore dhe Tregje” zëvendësohet me fjalën “Agjencia për Ushqim dhe Veterinari”.

### **Neni 6**

Neni 11 i Udhëzimit Administrativ bazik, fshihet.

### **Neni 7**

Neni 12 paragrafi 1 të Udhëzimit Administrativ bazik, fjalia “Departamenti për Politika Bujqësore dhe Tregje” zëvendësohet me fjalën “Agjencia për Ushqim dhe Veterinari”.

### **Neni 8**

#### **Hyrja ne fuqi**

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Faton PEÇI**

Ministër i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

